

Policia bastisë shtëpitë e të dyshuarve për plagosjen në Prizren, arrestohet një prej tyre



23/05/2024 09:32



Policia e Kosovës ka dhënë detaje për plagosjen e mbrëmshme në Prizren, ku sipas tyre një person ka raportuar në polici se derisa ishte së bashku me dy persona, pas një mosmarrëveshje janë sulmuar me mjete të forta si dhe me armë zjarri, nga tetë të dyshuar.

Dy nga viktimat kanë pranuar tretman mjekësor dhe më pas njëri nga ta është liruar, ndërsa tjetri është transferuar për trajtim të mëtutjeshëm, shkruan Lajmi.net

Në raportin 24 orësh Policia njofton se me vendim të prokurorit është bërë bastisja në dy lokacione, ku gjatë kontrollit është hasur dhe arrestuar njëri nga të dyshuarit meshkuj kosovarë, po ashtu është hasur dhe një kamionetë që dyshohet se është përdorur në kryerjen e veprës ku brenda saj janë gjetur dhe konfiskuar 37 fishekë që dyshohet të jenë të armës me gaz.

I dyshuari është dërguar në mbajtje dhe po ashtu është klasifikuar si vrasje në tentativë.

"Prizren 22.05.2024, 19:26. Viktima mashkull kosovar, ka raportuar se derisa ishte së bashku me dy viktimat meshkuj kosovarë, pas një mosmarrëveshje janë sulmuar me mjete të forta si dhe me armë zjarri, nga tetë të dyshuar meshkuj kosovarë. Dy nga viktimat kanë pranuar tretman mjekësor dhe më pas njëri nga ta është liruar, ndërsa tjetri është transferuar për trajtim të mëtutjeshëm. Në vendin e ngjarjes në dy lokacione janë gjetur dhe konfiskuar tre gëzhoja. Me vendim të prokurorit është bërë bastisja në dy lokacione, ku gjatë kontrollit është hasur dhe arrestuar njëri nga të dyshuarit meshkuj kosovarë, po ashtu është hasur dhe një kamionetë që dyshohet se është përdorur në kryerjen e veprës ku brenda saj janë gjetur dhe konfiskuar 37 fishekë që dyshohet të jenë të armës me gaz. Pas intervistimit me vendim të prokurorit i dyshuari është dërguar në mbajtje", bëhet e ditur në raportin 24 orësh të Policisë së Kosovës.

Më shumë nga nebi

by LaptopMedia



Artikuj të ngjashëm



May 23, 2024

Qytetari në Leposaviq kërcënohet vazhdimisht me mesazhe, policia nis hetimet




May 23, 2024

Gjendet e vdekur një grua në Pejë



May 23, 2024

Komisioni për Legjislacion miraton Projektligjin për marrëveshjen e burjeve me Danimarkën...




May 23, 2024

Sot pritet të shpallet aktgjykimi ndaj dy të dyshuarve për vrasjen...



May 23, 2024

U pyet për simbolet ruse në veri, Elshani i thotë gazetares...



May 23, 2024

Plagosja e tre personave në Pejë – Policia arreston një person,...



info@lajmi.net
Tel: +383 49 131 131
Rr: Zenel Salihu nr. 28, zyrja nr. 5

RRJETET SOCIALE



Other Links

Fact-Checking Policy
Ethics Policy
Corrections Policy
Ownership & Funding Information
Editorial Team Information